

Aplikimi për leje për rishikimin e kushteve të lejes së ndërtimit në Këshillin Kombëtar të Territorit

Në bazë të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe në mbështetje të VKM-së nr. 725, dt. 2.9.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit", që prej muajit nëntor 2015 ka filluar punën Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), si një institucion publik qëndror në varësi të ministrit përgjegjës për zhvillimin urban. Ajo kryen funksionet e Sekretariatit Teknik pranë Këshillit Kombëtar të Territorit.

Me shërbimin me një ndalesë dhe procedura të thjeshtuara, transparente dhe të shpejta, reduktohen barrierat administrative dhe përmirësohen praktikat e aplikimit për lejet përkatëse.

Dokumentacioni i nevojshëm për leje për rishikimin e kushteve të lejes së ndërtimit në Këshillin Kombëtar të Territorit:

Dokumentet tekniko-ligjore të nevojshme për të aplikuar për lejen e ndërtimit pranë AZHT-së (sipas përcaktimeve të nenit 48 të Ligjit nr. 107/2014) janë:

- Kërkesë e arsyetuar të subjektit të pajisur me leje ndërtimi, shoqëruar me relacionin përkatës, të firmosur nga projektuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve;
- Projektet e ndryshuara;
- Autorizim nga zhvilluesi për aplikantin (në rast kur aplikanti nuk është zhvillues i projektit);
- Licencat profesionale të projektuesve;
- Kopje e mandatpagesës së tarifës së aplikimit.

Hapat e procedurës:

- Kërkesa për leje për rishikimin e kushteve të lejes së ndërtimit paraqitet për shqyrtim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, i cili mundëson edhe ngarkimin, lehtësisht, të dokumentacionit shoqëruar të kërkesës për leje.
- Autoriteti shqyrton kërkesat për leje për rishikimin e kushteve të lejes së ndërtimit, brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së tyre. Në rast mangësie në dokumentacion, njoftohet aplikuesi që, brenda të njëjtit afat, të kryejë plotësimin e dokumentacionit.
- Në mbledhjen e radhës së saj KKT-ja vendos për:
 - miratimin e lejes për rishikimin e kushteve të lejes së ndërtimit
 - refuzimin e lejes për rishikimin e kushteve të lejes së ndërtimit
- Vendimi njoftohet nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit dhe botohet në regjistër, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit.

Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit:

Brenda 10 ditëve nga kërkesa për leje. Në mbledhjen e radhës të KKT-së vendoset në rend dite për shqyrtim dhe miratim.